



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ Prot.,

Tiranë më _____.____.2025

V E N D I M

Nr. 20, datë 03. 11.2025

PËR

“Përcaktimin e sipërmarrësit One Albania sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg, vendosjen e masave rregulluese për shërbimin e terminimit, heqja e statusit FNT si dhe masave rregulluese në tregun e tranzitimit të thirrjeve në rrjet fiks ”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z. Gentian	Sala	Kryetar
Znj. Edlira	Dvorani	Anëtare
Z. Lorenc	Bako	Anëtar
Z. Bleron	Dokle	Anëtar
Z. Armer	Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Xhilda Hoxha në mbledhjen e datës 03. 11.2025, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it, miratuar me vendimin nr.7, datë 16.2.2017 si dhe ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Përcaktimin e sipërmarrësit One Albania Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese për shërbimin e terminimit, heqja e statusit FNT si dhe masave rregulluese në tregun e tranzitimit të thirrjeve në rrjet fiks ”

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 87 e në vijim i Kreut XIII-të “Analiza e Tregut dhe Fuqia e Ndjeshme në Treg”, Kreu XIV-të, “ Detyrimet për akses ndaj sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg”, të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
2. Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 44/2015);

3. Rregullore nr. 9, datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut”, e ndryshuar;
4. Rregullore për Procedurat e Këshillimit Publik, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 21, datë 7.12.2021.
5. Vendimin Nr.11, datë 27.08.2025, “Për miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse– Këshillim Publik”.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
2. Relacioni Shoqërues i Projekt Vendimit;
3. Dokumenti: “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse - Dokument Përfundimtar” i cili përmban si Aneks 2: Komentet në këshillim publik nga palët e interesuara si dhe qëndrimi i AKEP për komentet;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Dokumenti “Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar” reflekton punën e Drejtorisë Rregullatore dhe Mbikëqyrjes së Tregut, i cili përmban si Aneks 2, komentet në këshillim publik nga palët e interesuara si dhe qëndrimi i AKEP për komentet.
2. Dokumenti “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse – Dokument Përfundimtar”:
 - a. është përgatitur pas kryerjes së këshillimit publik të zhvilluar në një periudhë 45 ditore, datë 28.08.2025 - 12.10.2025, si dhe përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për komentet (Aneks 2, i dokumentit).
 - b. nga pikëpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në Ligjin nr. 54/2024 si dhe Rregulloren për Analizën e Tregut 9/2009;
 - c. nga pikëpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizën e tregut në nenet 87 e në vijim i Kreut XIII-të, “Analiza e Tregut dhe Fuqia e Ndjeshme në Treg”, Kreu XIV-të, “Detyrimet për akses ndaj sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg”, të Ligjit nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” si dhe listën e tregjeve të përcaktuara në Rregulloren nr. 9, datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut”, e ndryshuar, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;
 - d. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Evropian dhe praktikën më të mirë rregullatore në vendet e Bashkimit Evropian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut në Shqipëri;
 - e. përkufizimin e tregjeve përkatëse dhe analizën e konkurrencës në tregjet përkatës dhe vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg (FNT) për tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse të analizuara;

- f. përfundimin se sipërmarrësi One Albania sh.a përmbush kriteret për FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale fikse, përfshirë arsyetimin për masat rregulluese për sipërmarrësit e vlerësuar me FNT, si dhe skemën e reduktimit të tarifave për terminimin fiks në rrjetet individuale të ofruesve të këtij shërbimi, *glide path* (FTR).
- g. përfundimin për de-rregullim të plotë të tregut me shumicë të tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse si dhe tërheqjen e masave rregulluese për sipërmarrësin One Albania sh.a në këtë treg brenda një afati kohor të arsyeshëm.
- h. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 92, Kreu XIV “Detyrimet për akses ndaj sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg”, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr.54/2024.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të pikave 1 të nenit 14 dhe 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, mbi bazën e vlerësimit të pozitës në tregjet përkatëse të sipërmarrësit One Albania Sh.a., sipas Dokumentit “Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Bazuar në dokumentin “Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar”, miratuar me VKD Nr.19, datë 03.11.2025, të përcaktojë:

1.1 One Albania sh.a, sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik fikse.

1.2 De-rregullim të plotë të tregut me shumicë të tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike fikse, heqje e statusit të FNT-së si dhe e detyrimeve rregulluese për sipërmarrësin One Albania sh.a.,.

2. Zona gjeografike me status FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik fikse është kombëtare apo territori i Republikës së Shqipërisë dhe dimensionin i plotë i produkteve/shërbimeve të tregut përkatës është sipas përcaktimeve të Dokumentit të Analizës së Tregut të miratuar me VKD Nr.19, datë 03.11.2025.
3. Sipërmarrësi One Albania sh.a. i përcaktuar sipërmarrës me FNT, në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik fikse, është i detyruar të zbatojë detyrimet përkatëse si më poshtë, por pa u kufizuar:
 - 3.1 Detyrimi i transparencës (Neni 93);
 - 3.2 Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 95);
 - 3.3 Detyrimi për akses dhe përdorim të elementeve specifike të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruar (Neni 98);
 - 3.4 Tarifa e Terminimit (Neni 100).

4. Detyrimet e mësipërme në piken 3, përfshijnë midis të tjerave:

4.1 Detyrimi i Mosdiskriminimit

- a. One Albania sh.a. detyrohet të zbatojë kushte të barabarta ndaj operatorëve të tjerë që ofrojnë shërbime ekuivalente dhe t'u ofrojë shërbime dhe informacion me cilësi të njëjtë sikurse për shërbimet e veta, filialet ose partnerët.
- b. One Albania sh.a. të publikojë Ofertën Referencë për Akses dhe Interkoneksion (ORI) dhe të bëjë përditësime sipas përcaktimeve të dokumentit të analizës.

4.2 Marrëveshjet e Aksesit

- a. One Albania sh.a. detyrohet të ofrojë ofertë për akses në rrjet, jo më vonë se 15 ditë nga marrja e kërkesës për akses.
- b. Marrëveshjet e lidhura me shkrim depozitohen pranë AKEP brenda 15 ditëve dhe bëhen të vlefshme për inspektim nga subjektet që kërkojnë akses.
- c. One Albania sh.a. detyrohet në publikimin e Ofertës Referencë, të përfshijë KPI dhe nivelet e shërbimit (SLA).

4.3 Detyrimi për Transparencë

One Albania sh.a. detyrohet të publikojë informacion në lidhje me:

- a. të dhënat financiare;
- b. specifikimet teknike dhe karakteristikat e rrjetit;
- c. termat dhe kushtet e përdorimit;
- d. tarifatat, përfshirë zbritjet e mundshme;

4.4 Detyrimi për akses dhe interkoneksion si dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit, për terminimin e thirrjeve në rrjetin fiks, Sipërmarrësi One Albania Sh.a., duhet:

- a. t'u ofrojë palëve të treta akses në elemente të veçanta të rrjetit dhe/ose faciliteteve, duke lejuar, ndërmjet të tjerash, zgjedhjen dhe/ose parazgjedhjen e bartësit dhe/ose ofertat e rishitjes së linjës së pajtimtarit;
- b. të mos anulohet aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë;
- c. të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;
- d. të ofrojë akses të hapur në ndërfaqet teknike, protokollet ose teknologjitë e tjera të rëndësishme, të domosdoshme për ndërveprimin e shërbimeve ose për shërbimet e rrjetit virtual;
- e. të ofrojë bashkëvendosje ose forma të tjera të përdorimit të përbashkët, përfshirë ndërtesat, tubacionet kablllore ose shtyllat, kullat;
- f. të krijojë kushtet e nevojshme për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve pikë fundore – pikë fundore, duke përfshirë facilitetet për shërbimet e rrjetit inteligjent;
- g. të ofrojë akses në sistemet mbështetëse funksionale ose sistemet e ngjashme informatike (software), të nevojshme, për të siguruar konkurrencë të ndershme në ofrimin e shërbimeve;
- h. të interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit.

Detyrimet e mësipërme, i referohen vetëm për mundësimin e terminimit të thirrjeve kombëtare, në rrjetin fiks One Albania dhe janë të zbatueshme sipas mundësive/aftësive teknike dhe ekonomike të sipërmarrësit One Albania Sh.a.

4.5 Detyrimi për rregullimin e tarifës për terminimin e thirrjeve në rrjetin fiks, Sipërmarrësi One Albania sh.a., duhet zbatojë reduktimin e tarifës së shërbimit të terminimit në rrjetin publik telefonik fiks të One Albania, sipas tabelës (glide-path):

Tabela: Reduktimi i tarifave të interkoneksionit në rrjetin fikse të One Albania

	Aktualisht	01.03.2026	01.09.2026	01.03.2027
One Albania (Lokal/Njëfish)	0.7	0.3	0.15	0.07

Shënim: Tarifat në Lek pa TVSH

5. One Albania Sh.a., si sipërmarrës me fuqi të ndjeshme në treg, i nënshtrohet detyrimeve të përcaktuara nga AKEP sipas nenit 92 të ligjit nr. 54/2024, Rregullores së Aksesit dhe Interkoneksionit si dhe përshkrimeve të detajuara më sipër, duke përfshirë dhënien e ofertës për akses ndaj kërkuesit brenda afateve, dorëzimin në afat të marrëveshjeve të lidhura (MI) pranë AKEP, publikimin dhe përditësimin e Ofertës Referencë për Akses dhe Interkoneksion (RIO), si dhe publikimin e marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit (SLA) dhe Treguesve Kryesorë të Performancës (KPI) për interkoneksion, rregullimin e tarifës për terminimin e thirrjeve në rrjetin fiks sipas skemës së reduktimit më sipër.
6. Sipërmarrësi One Albania sh.a., për statusin me FNT për tranzitimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik fikse, në referencë me përcaktimin me sipër pika 1 (1.2), sipas së cilës, statusi i FNT-së si dhe e detyrimeve rregulluese për sipërmarrësin One Albania sh.a., të përcaktuara me Vendim, Nr. 22, datë 30.03.2018 për “Përcaktimin e sipërmarrësit One Albania Sh.a. (ish-Albtelecom Sh.a.) si sipërmarrës me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese për shërbimet e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik fikse”, hiqen. Afati me zbatim, jo më herët se 6 muaj nga miratimi i këtij vendimi.
7. Afati i vlefshmërisë së statusit me FNT në tregjet përkatëse për sipërmarrësin One Albania, është deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër nga AKEP mbi bazën e analizës së tregut të kryer sipas Ligjit 54/2024.
8. Dokumenti “Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar” i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë e tij.
9. Vendim, Nr. 22, datë 30.03.2018 për “Përcaktimin e sipërmarrësit One Albania Sh.a. (ish-Albtelecom Sh.a.) si sipërmarrës me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese për shërbimet e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik fikse”, shfuqizohet
10. Ky Vendim të publikohen në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka